



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:325828  
Datë: 16.12.2024  
Numri i dokumentit: 06606971

C.nr.1131/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditëses J.K nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Z.H nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës, me datë 16.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditëses J.K nga Rahoveci, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, në çështjen juridike kontestimore C.nr.1131/2024.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja J.K nga Rahoveci, pranë kësaj gjykate me datë 12.09.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. Z.H nga Prishtina, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike - kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

Kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr.1131/2024 të datës 26.11.2024, e ka ftuar paditësen që në afat prej 3 (tre) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

I autorizuari i paditëses Av. Z.H me parashtrësën e datës 06.12.2024, e ka njoftuar gjykatën se me datën 05.12.2024, e ka pranuar Aktvendimin e lartcekur. Po ashtu i njëjti ka theksuar se është e pamundur pagesa e taksë gjyqësore, meqenëse është në udhëtim jashtë vendit, si dhe ka kërkuar nga gjykata që afati për pagesën e taksës të shtyhet deri në kthimin e tij nga udhëtimi.

Kjo gjykatë arsyen e përfaqësuesit të autorizuarit të paditëses për mos pagesën e taksës gjyqësore, e vlerëson si të pabazuar, kjo për faktin pasi që i njëjti ka mundur ta dorëzoj

parashtrësën për shtyrjen të afatit, i njëjti ka pasur mundësi që edhe ta paguaj taksën gjyqësore sipas aktvendimit C.nr.1131/2024 të datës 26.11.2024.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me datën 05.12.2024, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësja nuk e ka bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 paragrafi 5 lidhur me nenin 387 paragrafi 1 pikë c) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,  
C.nr. 1131/2024, me datë 16.12.2024.

B. profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.